

FIKRET RAMADANI

STUDIMET UTOPIKE NË PROCES

Abstrakt

Studimet letrare, thuajse kanë eksploruar në të gjitha drejtimet në panteonin e letrave shqipe, ku më shumë e ku më pak. Ndërkaq, studimet për veprat utopike/distopike mbesin pak të hulumtuara. Në këtë punim, në pjesën e parë, pasqyrohet një tablo e përgjithshme për procesin e studimeve të orientuara kah kjo tematikë; veprat e analizuara dhe studiuesit që kanë dhënë kontribute. Ndërsa në pjesën e dytë, analizohet një vepër me substrat të tillë, si kundërvënie ndaj utopisë socrealiste, dhe më pas në formë diskutimi paraqiten disa mendime për kahjet e reja hulumtuese e zhvillimore në këtë drejtim.

Fjalët kyçe: *letërsi, utopi, socrealizëm, roman.*

Që në krye të herës mund të konkludojmë se substrati i veprave e punimeve utopike/distopike në studimet e letrave shqipe, nuk mund të krahasohet me fushat e tjera tanimë të hulumtuara në një masë të konsiderueshme prej studiuesve të letërsisë. Ky konstatim i llogaritjes së prurjeve në këtë fushë bazohet në tri shtylla kryesore. E para: sasia tepër e vogël e numrit të botimeve të veprave që kanë për objekt këtë problem. Hiq këtu veprën e Sabri Hamitit¹ dhe letërsia shqipe mbetet pa një studim të mirëfilltë të kësaj natyre. E dyta: mungesa e një veprimtarie shkencore e tipit të konferencës apo të tryezës shkencore me temë bosht ose edhe me tema alternative (nëntema). Theksojmë, një konferencë shkencore që ishte organizuar ca vite më parë nga Universiteti i Tiranës, konkretisht Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë me titull: *Letërsia dhe Politika*. Në fakt, kjo temë është pak a shumë e ngjashme me temën tonë, por drejtpërdrejt nuk ka përkime as titulli e as kumtesat e pjesëmarrësve. E treta: mungesa e përkthimit të veprave studimore në gjuhën shqipe që janë shkruar në ndonjërin nga gjuhët e kontinentit të vjetër. Kujtojmë se shpeshherë, librat e përkthyer në gjuhën tonë kanë qenë motivim për të ndjekur modele të përafërta të autorëve europianë² dhe të tillët kanë

¹ Sabri Hamiti, *Utopia letrare*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 2013.

² Kupto: jo në kuptimin gjeografik, por në atë kulturor dhe shkencore. Pra, mund të kemi studiues që vijnë nga vende që gjeografikisht nuk janë pjesë e Europës, por në

ndikuar në marrjen e iniciativave për të bërë punë të ngjashme në dijet tona. Gjithashtu, në të shumtën e rasteve, formimi teorik dhe qasja me anë të metodave më moderne në studimet letrare prej studiuesve të huaj, ka qenë bazament edhe në formimin e letrarëve tanë.

Këto tri mungesa, që do t'i quaja esenciale, për këtë fushë studimi, në një formë u kanë tkurrur rrugën prurjeve të reja në këtë drejtim, që në fakt është një rrugë jashtëzakonisht e rëndësishme për letërsinë shqipe; duke njohur rrugën dhe zhvillimin nëpër të cilën ka kaluar kjo letërsi.

Nga këto konstatime, mund të vërehet se vetëm vullneti individual (si në shumë raste të veprave më të rëndësishme të kulturës botërore) dhe syri i mprehtë i studiuesit bëhet nismëtar serioz i kësaj çështje, siç ka ndodhur edhe më parë me penën e S. Hamitit.

Në librin e tij tanimë të cituar më sipër, Hamiti bën një vështrim të përgjithshëm, duke nisur që nga aspekti historik i përdorimit të leksemës utopi dhe distopi e deri të leximet e disa prej autorëve tanë më të rëndësishëm në këtë prizëm. *Utopia* e tij është e larmishme do të thosha; kjo ngase rrok një distancë bukur të madhe kohore dhe kalon nga letërsia e romantizmit drejt letërsisë moderne e deri të letërsia e realizmit socialist³, që do të thotë se nuk kemi interpretim të cunguar vetëm në një periudë letrare, ose të vetëm disa shkrimtarëve të formacionit të caktuar. Një qasje e tillë e serioze, për një çështje të komplikuar siç është kjo e studimit të veprave me elemente utopike në letërsinë shqipe, mbetet nismëtare në këtë fushë.

Prej një vështrimi siç është ky i radhëve më lart, konkluzionet mbesin të qarta. Sakaq është i qartë edhe konkluzioni se kjo është rruga që është shkelur më pak në letërsinë shqipe. Prandaj, është kaq i nevojshëm orientimi në këtë vijë, po aq edhe një mundësi e mirë për ta prekur këtë çështje në këtë konferencë që përpos të tjerash ka për qëllim vlerësimin, analizimin, rezultatet, pse jo edhe projektimin e procesit të studimeve letrare, problemeve, rezultateve dhe kahjeve të reja.

Fillesat e përdorimit të termave “utopi” dhe “distopi”

Duke ndjekur kronologjinë e përdorimit të termit *utopi*, na del se i pari që përdori neologjizmin utopi ishte dijetari Thomas More në veprën e tij kapitale “*Utopia*” (1516)⁴. Ndërsa në aspektin etimologjik, rrënja e fjalës utopi vjen nga greqishtja: *ou-jo* dhe *topos* vend, do të thotë vend që nuk ekziston.

aspektin e progresit jetësor quhen europian. Siç ndodh me autorët amerikanë, australianë e të vendeve të tjera.

³ Ndarjet e formacioneve letrare i kemi llogaritur sipas ndarjeve të zakonshme në historitë e letërsisë shqipe.

⁴ Thomas More, *Utopia* (second edition), shfletuar për herë të fundit më 10 dhjetor 2021, në:

<https://www.google.com/books/edition/Utopia/SR7BAAQBAJ?hl=en&gbpv=1>

Rrjedhimisht, vend që nuk ekziston, por në fakt që kërkohet për të kaluar nga idealizimi në realizim. Me aq sa synon utopi për të krijuar një vend ideal e të përsosur të një komuniteti në shoqërinë e madhe botërore, po kaq është në kundërvënienë të njerëzore: “*Pohimi i idealeve është mohimi absolut i reales. Projekti i shoqërisë së përsosur është mohimi i shoqërisë së padrejtë.*”⁵ Kësisoj, si kundërvënienë ndaj arritjes së utopisë, lindi *distopia* (si shprehje mendohet se është vënë në funksion rreth shek. XIX nga Stuart Mill- i) nga fjala greke *dus*, e keqe apo jo normale, dhe *topia* vend. Pra e kundërta e utopisë është distopia dhe si tillë, do të inkorporohet edhe në botën e letrave. Në letërsinë botërore ekzistojnë disa vepra distopike siç mund të përmendim këtu: *Ne*, i Jevgenij Zamjatin, *Animal Farm* dhe *1984* të Gorge Orwell-it apo *Brave New World* e Huxley-it, kryesisht si kundërvënienë ndaj formave moniste të politikave apo tendencave për të arritur në stadi të tilla. Pra gjeneza e idealeve në fillim vjen nga botëkuptimet filozofike të shoqërisë imagjinare. Pastaj, kaloi në aplikime politike.

Atdheu utopik

Shqipëria ideale ka qenë ëndërr e kamotshme e shqiptarëve. Ajo do të kalojë në trajtë letrare më seriozisht në periudhën e Rilindjes. Shkrimtarët tanë romantikë këtë ëndërr e shprehën në vargje e në rreshta. Megjithatë, thuajse gjithsecili prej tyre pati projektionin e vet imagjinar për Atdheun. Mirëpo, është e natyrshme që në artin e të shprehurit, individë të caktuar të pasqyrojnë ndjenjat dhe mendimet në mënyra të ndryshme, kush më me shumë zotësi e kush më me pak. Shqipëria utopike më së miri e më artistikisht do të paraqitet pikërisht nga figurat më me zë të Rilindjes kombëtare: Naimit dhe Samiut. I pari me gjuhën e ëndërrimtarit krijoi Shqipërinë e dashurisë, gjallërisë dhe jetës të skalitur me vuajtjet e mërgimitarit. I dyti e paraqiti Atdheun të pandarë, të sigurt e jo fort me ngazëllim e sentiment, por më shumë me racionalitet. “*Vepra e tyre në botën shqiptare dhe historia dëshmojnë që kryetema e tyre njerëzore e krijuese është një Shqipëri e ëndrrave dhe e dëshirave. Ata janë tashmë në ballin historik të idealistëve shqiptarë. Të idealistëve dhe të utopistëve.*”⁶ Kurse ndërmjet dy kahjeve të ndryshme të vëllezërve Frashëri për projektionin e Shqipërisë është figura e At Zef Pllumit. Deri këtu kemi një Shqipëri të projektuar e të ëndërruar. Te vëllezërit Frashëri, Shqipërinë e kemi ende të pabërë, kurse te At Zef Pllumi çështja ndryshon. Kemi një projektim të Shqipërisë së bërë, por të drejtuar e të udhëhequr sipas sistemit sociorealist, që në një mendje me projektionin e Pllumit, Ajo mbetet ende e pabërë.

⁵ Sabri Hamiti, *Utopia letrare*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 2013, f. 18.

⁶ *Po aty*, f. 84.

Në këtë vazhdë mendimi shkojnë edhe shkrimtarët e më vonshëm që vetëdijshëm dolën kundër një sistemi të tillë, që me veçantitë e veta, i dhanë letërsisë shqipe krijime me nivel të lartë estetik.

Një utopi në letër

Sistemet e caktuara utopike, me projeksion të tillë që në ngjizje, thuajse gjithherë kanë dhënë efekt kundërvënës në masë, pavarësisht distancës kohore kur kanë filluar kundërshtimet e para. Kësisoj, kjo formë e udhëheqjes mbetet arsye dominuese se përse kemi lindje të veprave me elemente distopike. Gjithsesi, formacionet e tilla politike shfrytëzuan të gjitha mundësitë dhe format për t'i ndaluar/cunguar veprat që potencialisht kundërshtojnë formate të tilla udhëheqjeje.

Gjithsesi, letërsia duhet të jetë e lirë, nëse është momenti i lindjes së një metode të re letrare, ajo duhet të lindë natyrshëm, nga vetë autorët e jo nga rrethanat ekstraletrare, sepse letërsia para së gjithash është krijim shpirtëror. Në qoftë se ajo imponohet, frytet e saj do të mungojnë. Te shkrimtarët që veprimtarinë krijuese e zhvilluan në Kosovë, Kosova e lirë ka qenë ëndërr, por jo pa Shqipërinë, sepse atëherë do të ishte e vetmuar. E kemi të vështirë që në thirrjet e shkrimtarëve shqiptarë të Kosovës (është fjala për shkrimet para luftës së fundit në Kosovë) të gjejmë ndonjë tezë që pas çlirimit, Kosova të jetë shtet i shkëputur nga Shqipëria. Liria e plotë e saj është projektuar vetëm bashkë me Shqipërinë. Prandaj mund të konkludohet se kundërvënia e intelektualëve /shkrimtarëve që jetuan e vepruan nën ombrellën e këtij sistemi ka qenë nevojë e kohës.

Ndërkaq, në anën tjetër, dihet që letërsia shqipe që lëvrohej në Kosovë, lindi e shkëputur nga letërsia AMË dhe nga një pjesë e traditës letrare shqiptare në përgjithësi. Ajo, pothuajse nuk ishte fare në kontakt me të dhe nuk ishte e informuar për atë që ndodhte në fushën e letërsisë brenda kufirit të shtetit shqiptar. Dihet që pengesë kryesore ishin pikërisht regjimet mbizotëruese.

Censura i detyroi autorët që të përdornin forma të shprehjes hermetike dhe simbolike. Prandaj, autorët rrekën për të shkruar vepra me elemente të fuqishme distopike, siç është rasti i Anton Pashkut, veprën e të cilit do ta vështrojmë shkurtimisht në këtë kumtesë.

Utopia për bashkim

Anton Pashku, luajti një rol të rëndësishëm në zhvillimin e veprës së shkruar në Kosovë. Është më se e vërtetë thënia për të, se ai është shkrimtar që nuk synon masat e gjera të publikut, por lexues të kualifikuar, dhe me shumë të drejtë albanologu Robert Elsie e ka krahasuar me Orwell-in dhe shkrimtarë të tjerë të famshëm të letërsisë botërore.

Romani “Oh”, padyshim, është njëri ndër romanet më me peshë në letërsinë shqipe. Natyrisht, ky roman vjen si vazhdimësi e traditës së tregimeve të shkurtra të Pashkut. Tanimë është i njohur pohimi se romani është i krijuar pa një fabul të zakonshme, pa një rrëfyes të identifikuar qartë dhe pa një

këndvështrim të veçantë e të fokusuar nga ana e shkrimtarit. Kjo përbën edhe një trajtë të re narrative në letërsinë shqipe që zhvillohej në Kosovë dhe jo vetëm. Vetë narracioni i romanit, siç shkruan S. Hamiti, i ngjan një rrethi që nuk ka mbarim – infinit. Sakaq, “*struktura e përmyllur e këtij romani siç shihet, ka të bëjë me rimarrjen e tekstit të fillimit, i cili është konfigurim i pamjes së brendshme të shpirtit*”⁷. Ky rreth narrativ jep mundësi tjetër: interpretim artistik dhe domethënës të veprës letrare. Nga këndej kuptohet se vepra qenka novatore (në kuptimin e përgjithshëm të fjalës) në një sistem letrar ku “novatorizmi më i madh” ishte poetika e realizmit socialist. Pra, autori e kapërcen vetëdijshëm një kanon të tillë artificial.

Në mendimin tonë, narracioni i ndërtuar në një format të tillë (infinit) ka të bëjë me pambarimin e presioneve ana e agresorëve dhe ushtrimit të formave detyruese të populli, që nuk e shijonte lirinë. Simbolika e pambarimit (infinitit) të vuajtjeve goditi fort shtresën intelektuale të kohës për vite me radhë, me të gjitha mjetet dhe format. Kjo është *Klithja* e Pashkut që nuk ka mbarim.

Edhe pa shkuar në interpretime të mëtejshme, lexuesi model⁸ mund të receptojë që në krye të herës se ky roman i takon natyrës së veprave distopike, në këtë rast si shmangie e poetikës së socrealizmit.

Autori, nëpërmjet fiksionit po tregonte realitetin (e kohës së shkrimit të romanit, kur Kosova qe nën Ish- Jugosllavi) të kaluarën historike, por po idealizonte edhe etapën e re drejt së ardhmes, pra të bashkimit, jo vetëm kulturor e shpirtëror, por edhe fizik e juridik. Që në fakt është edhe një distopi reale ndaj një sistemi të tillë. Me afinitetin krijues, autori arriti të mbrohej nga regjimi, duke përdorur metaforën “*mbrohet nga censura e tmerrshme e totalitarizmit, nëpërmjet ironisë përmbys një botë të tmerrshme për njeriun*”⁹ sakaq, ndërton edhe një botë të re kundrejt asaj që po mbyste gjithçka, qoftë nga ana nacionale, qoftë nga ajo artistike e shpirtërore ndaj njerëzimit, më saktë ndaj shqiptarëve që po jetonin në sistemin totalitar – jugosllav. Këtë pikërisht ia mundësonte aftësia e tij në përdorimin e metaforës dhe simbolit, si figurat më qendrore hasur në veprat distopike të letërsisë së huaj dhe asaj shqipe.

Nga këtu, edhe një herë, u bë me dije e u konfirmua se ribashkimi i popullit shqiptar natyrisht për atë kohë ishte i pamundur. Mbase nuk kishte ribashkim politik e juridik, ekzistonte një formë tjetër, bashkimi kulturor i

⁷ Viola Isufaj, “Loja e rebuseve (Rasti Pashku e Camaj)”, botuar në: Materialet e punimeve të *Seminarit XXXI Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare*, Prishtinë, 13-25 gusht 2012. Cituar sipas librit të botimeve: <https://filologjia.uni-pr.edu/desk/inc/media/46C38B2F-61E4-4350-A0FB-C2C85607FB3D.pdf>, f. 52.

⁸ Kupto mendimin e U. Eco-s për këtë term.

⁹ Sabri Hamiti, *Tematologjia*, Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, Prishtinë, 2005, f. 156.

shqiptarëve! Natyrisht, asgjë më mirë se letërsia nuk e formulonte dhe nuk e projektonte këtë gjë. Ja si ëndërronte hermetikun: *"Do të ketë vetëm një shtypshkronjë, e cila do të botojë vetëm një abetare, vetëm një libër leximi, vetëm një libër të historisë, vetëm një libër të filozofisë, vetëm një tregim... vetëm një dramë, vetëm një sonet... vetëm një gazetë të përditshme... do të ketë vetëm një radiotelevizion, i cili do të emitojë vetëm një kangë... vetëm një lajm, vetëm një informatë... vetëm një vështrim, vetëm një kritikë letrare..."*¹⁰ Pra një utopi ëndërruar në vete, për kohën e publikimit të veprës, që realisht është një distopi ndaj sistemit politik të kohës që mbizotëronte në ato vite në Kosovë.

Gjithashtu, kjo mbetet vepra më delikate dhe më goditëse për kohën në të cilën është shkruar dhe për sistemin politik imponues të cilit i drejtohet. Për këtë arsye mund të themi se romani "Oh", sigurisht, deri tani është vështruar në shumë dimensione studimore, nga studiuesit më të rëndësishëm të historisë, kritikës e teorisë letrare në kulturën tonë, po si të thuash, ky vështrim hap edhe një dritare të re, për të parë një faqe të re të artit të pashtershëm të Anton Pashkut, edhe te vepra *Sinkopa* e ndoshta edhe ndonjë tregim tjetër a shkrim të ngjashëm fiktiv botuar në shtypin e kohës.

Për një projektion në vazhdim

Sikurse Pashku, i cili shkroi dhe botoi brenda një sistemi që e kundërshtonte me anë të penës, kemi edhe shkrimtarë të tjerë që ishin në një mendim me Pashkun. Ndërkaq, kemi edhe autorë që u larguan nga sistemi monist, për të kundërshtuar këtë sistem, pak më hapur se të tjerët që funksiononin brenda tij. Siç është rasti i Kasëm Trebeshinës e ndonjë tjetri. Veprat e tyre kërkojnë një qasje tjetër teorike.

Megjithatë, projektet "utopike", parimisht e historikisht nuk kanë qenë të mundshme për t'u realizuar. Në vazhdim po japim një projektion joideal, por besojmë të realizueshëm për procesin e studimeve letrare në rrafshin utopik dhe distopik që do të vijë në vijim; që natyrshëm rrjedh si nevojë e studimit të krijimeve me substrat të tillë. Kjo çapitje fillestare le të shërbejë më shumë si ngacmim i mendimit kritik sesa për të sjellë një tablo të përgjithshme për mënyrën e vlerësimit të produktit letrar. Pra, çështjet që mbesin të mendohen e të praktikohen më tej, përveç të tjerash, mund të jenë edhe këto:

Si do të mbetet çështja e veprave të autorëve minorë në letërsinë shqipe, të cilat kanë elemente të kundërvënies ndaj realitetit gjatë kohës së pushtimit në Kosovë dhe udhëheqjes moniste në Shqipëri? Çfarë kritere teorike duhet të ndjekim për t'i konsideruar këto vepra si vepra distopike? Dhe, duhet detyrimisht që vepra distopike t'i quajmë vetëm ato vepra që sot konsiderohen si të arrira estetikisht? A është i saktë mendimi i Gadameri-it se një tekst

¹⁰ Anton Pashku, *Oh*, Rilindja, Prishtinë, 1986, f. 78.

kuptohet në mënyrën e vet nga çdo epokë dhe çfarë roli ka kjo tezë në raport përcaktimin e qasjes teorike ndaj veprave me elemente distopike?

Në anën tjetër; konsiderohen vepra distopike edhe veprat që nuk janë të pasura me simbolika jo të forta e labirinthe që nuk shkojnë deri në abstraksione? Me çfarë kritere t'i trajtojmë? Po me veprat e shkrimtarëve që botuan jashtë kufijve të pushtuesve që projektonin një utopi të vetën? Si t'i trajtojmë? Do t'i quajmë krijime distopike edhe format e tjera të të shprehurit përveç prozës së gjatë?

Këto mbesin vetëm disa nga pyetjet që mbesin të hapura për diskutim, në aspektin teorik të vlerësimit të produktit artistik – distopik.

BIBLIOGRAFI

Eco, Umberto, *Për letërsinë* (përktheu: Donika Omari), Dituria, Tiranë, 2010.

Hamiti, Sabri, *Utopia letrare*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 2013.

Isufaj, Viola, “Loja e rebaseve (Rasti Pashku e Camaj)”, Botuar në: *Materialet e punimeve të Seminarit XXXI Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare*, Prishtinë, 13-25 gusht 2012. Cituar sipas librit të botimeve: <https://filologjia.uni-pr.edu/desk/inc/media/46C38B2F-61E4-4350-A0FB-C2C85607FB3D.pdf>, f. 52.

More, Thomas, *Utopia* (second edition), shfletuar për herë të fundit më 10 dhjetor 2021, në:

<https://www.google.com/books/edition/Utopia/SR7BAGAAQBAJ?hl=en&gbpv=1>

Pashku, Anton, *Oh*, Rilindja, Prishtinë, 1986.

SUMMARY

LITERARY UTOPIA AND STUDIES IN PROGRESS

Literary studies have almost explored in all directions in the pantheon of Albanian letters, where more and where less. Meanwhile, studies on utopian/dystopian works remain little researched, as will be proven during the elaboration of this topic. In this paper, in the first part, an overview of the process of studies oriented towards this topic is reflected, emphasizing the studies so far and the empty space in this field; analyzing works and contributing researchers, who made the first serious moves in this field. While, in the second part, the novel "OH" by Anton Pashku is analyzed, a work with

such a substrate as opposed to the socialist utopia as a whole. We are aware that this initial edition will serve more as a stimulation of critical thought than to bring a specific opinion on how to evaluate the literary product according to this point of view. At the very end, in the form of a discussion, some thoughts on new research and development directions in this direction are presented.